



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 9643 /2023
Data : 10.11.2023

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e dhjetë -X- për vitin 2023 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 18.10.2023 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Amir Bushi** (Udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale), **Ilir Kaloshi** (Përfaqësues nga Kompania NPL Pastrimi sh a), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtar për Informim) .

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2023.
3. Plani i biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2024.
4. Draft Plani i Veprimt për Parandalimin e Dhunës në Familje 2024-2026.
5. Draft Plani i Punës së Ekipës për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijëve 2024-2026.
6. Propozim vendim për lirim nga taksa administrative për legalizimin e ndërtimeve pa leje për kategoritë e dalura nga lufta.
7. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.
8. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2023 i N.P.L Pastrimi sh.a.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte një zëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- të hyrat vetanake gjatë nëntë mujorit të vitit 2023, të hyrat janë realizuar në shumë prej 292,919.35 € dhe paraqesin 52.2 % të të hyrave të përgjithshme të planifikuara vjetore, ndërsa krahasuar me realizimin e nëntë mujorit të vitit paraprak 2022 kemi një rritje prej 28,490.13 €. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-shtator 2023 është në shumë prej 2,125,565.24 € apo 63.46 %. Shpenzimet për paga dhe shtesa shënuan vlerën prej 1,502,955.67 € apo 88.26 %. Shpenzimet për mallra dhe shërbime shënuan vlerën prej 312,224.88 € apo 67.14%. Shërbimet komunale shënuan vlerën prej 56,644.21 € apo 58.69%. Shpenzimet për subvencione dhe transfere arritën shumën prej 64,008.08 € apo 64.00 %. Shpenzimet kapitale arritën vlerën prej 189,732.40€ apo 19.25 %.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANRA –SHTATOR 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Plani i biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Ilir Kaloshi thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I BIZNESIT I NPL PASTRIMI SH A PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Draft Plani i Veprimit për Parandalimin e Dhunës në Familje 2024-2026.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Amir Bushi thekson:- plani është përgatitur duke pasur parasysh që si komunë do të na shërbejë për me bërë parandalimin e dhunës në familje. Si komunë na obligonë Ligji kundër dhunës në familje për me pasur një Plan në mënyrë se si me i trajtuar këto raste.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NË FAMILJE 2024-2026 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Draft Plani i Punës së Ekipës për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijëve 2024-2026.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Amir Bushi thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson:- vizita e policisë të cilat po bëhen nëpër shkolla çfarë efekti po ka te fëmijët, sa po kuptohen vetëm uniforma po i frymëzon me një far mënyre.

Amir Bushi thekson:- në takimet të cilat i kam pasur me nivelin e lartë të Policisë dhe unë mendojë që duhet me pasur një far harmonizimi të ligjëratave apo projekteve të tilla për shkak se ju jep një far krenosje fëmijëve dhe ata të cilët ligjërojë duhet të jenë më ekspertë për të drejtat e fëmijëve për arsye se në këtë rast nuk duhet me ua shpjeguar vetëm të drejtat por edhe përgjegjësitë e fëmijëve për shkak se nëse një fëmijë e ka një të drejtë me vijuar mësimin i mvëshën edhe disa përgjegjësi të tjera. Për çështje të ligjëratave është prej nivelit më të lartë që i përcaktojnë agjendat për ligjërata nëpër shkolla.

Hisni Luri thekson:- policia e Kosovës ka një kalendarë të aktiviteteve dhe në kuadër të kalendarit të aktiviteteve ashtu siç kemi edhe ne në kalendarin për aktivitet për shënim të datave dhe këto shkojnë sipas kalendarit për ditë të caktuara. Ftesë prej neve nuk kanë pasur përveç policisë së trafikut për shpjegimin se si të sillen në komunikacion. Lejimi për mbajtjen e ndonjë aktiviteti të policisë nëpër shkolla bëhet prej regjionit

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU DRAFT PLANI I PUNËS SË EKIPËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE 2024-2026 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Propozim vendim për lirimin nga taksa administrative për legalizimin e ndërtimeve pa leje për kategoritë e dalura nga lufta.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- propozim vendimi ka të bëjë me taksën e legalizimit të ndërtimeve pa leje ndërtimore respektivisht për lirimin nga pagesa e kësaj takse për kategoritë e dalura nga lufta , për familjet e dëshmorëve , invalidët e luftës , veteranët e UÇK-së , viktimat civile si dhe familjet e tyre. Për lirimin nga taksa të këtyre kategorive jemi bazuar në Ligjin me numër 06L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje ndërtimore neni 20 pika 11 që thekson që me vendim të kuvendit të komunës komunat mund të caktojnë taksa më të ulëta se sa taksat e caktuara me këtë nen në mënyrë që t'i lirojnë kategoritë e tyre nga pagesa.

Refet Kalisi thekson:- e përkrahi këtë propozim vendim është i qëlluar por është mirë mos me u keqpërdorë, pra ne të lirohen ata të cilët e meritojnë

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR LIRIMIN NGA TAKSA ADMINISTRATIVE PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE PËR KATEGORITË E DALURA NGA LUFTA QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- materialin e kemi përcjell me kohë dhe janë shënuar në mënyrë të detajuar dhe përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI PERIODIK LIDHUR ME PROGRESIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2023 i N.P.L Pastrimi sh.a.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Ilir Kaloshi thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Refet Kalisi thekson:- taksën për heqjen e mbeturinave e kemi ngritur nga pesë euro në gjashtë euro e gjys dhe nuk keni marr ndonjë vendim për ngritjen e pagave të punëtorëve për shkak se janë me paga të ulëta.

Sevdi Dernjani thekson:- një bisedë të cilën e kam pasur me kryeshefin ekzekutiv është potencuar që në muajin dhjetorë do ta ryshqyrtonë mundësinë për ngritje të pagave.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI FINACIAR PËR PERIUdhËN JANAR-HTATOR 2023 I NPL PASTRIMI SH A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7.Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Refet Kalisi thekson:- si është puna me çështjen e ujit edhe pse e di që është problem.

Arsim Dernjani thekson:- punëtorët e kompanisë “Bifurkacioni” janë duke i zhvilluar punimet kadale dhe kam kërkuar që me i shtuar kapacitete dhe kanë premtuar që nesër do të vijnë për këtë çështje sepse kam kërkuar një raport prej tyre por nuk ma kanë sjell.

Kryesuesi thekson:- në momentin që vendoset ormatësi a llogaritet pagesa.

Arsim Dernjani thekson:- sipas përfaqësuesve të kompanisë kanë potencuar se në momentin që vendosen orëmatësit pastaj do të fillon procedura me pagesë .

Refet Kalisi thekson:- edhe në kuvend kam potencuar për çështje të pagesës dhe drejtori ka potencuar që në momentin që do të vendosen orët në Han të Elezit do të fillon pagesa e ujit është mirë me ju shpjeguar qytetarëve. Te fabrika e ujit duhet të vendoset një agregat sepse mund të fillon sezona e dimrit dhe mund të ketë ndërprerje të energjisë elektrike.

Arsim Dernjani thekson:-çdo herë që kam biseduar me z.Jetonin ka potencuar që në momentin që vendosen të gjitha orët do të fillon pagesa. Me përfaqësuesin e kompanisë kam kontaktuar dhe i kam sugjeruar që me vendosë edhe agregatin në mënyrë urgjente.

Natya Kalisi thekson:- ne kemi marr së fundmi një raport të studimit të fizibilitetit të ujit dhe çdo kritikë e cila na hudhet për ujin ne tash sa kemi ardhur dhe në menaxhim më herët kompania “Bifurkacioni” nuk e ka pasur por jemi na ato të cilët i kemi shtyer proceset që do të thotë se duhet të kemi pak durim sepse është diçka që është tu funksionuar e në vitin tjetër janë duke u planifikuar edhe mjete financiare me u ndarë që kompania “Bifurkacioni” me investuar. Është diçka evidente që momentalisht është tu pasur keqpërdorime por nuk dihet edhe rrjeti i ujësjesit por janë disa hapa të cilët janë në atë raport që është dashur me u kryer në vitin 2013 -2014.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:10.

Procesmbajtësi
Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

